

15 VJET ZYRA E KOMISIONERIT
Konferenca V Kombëtare
“E Drejta për Informim - Hapje, Transparencë, Digjitalizim”

Të nderuar pjesëmarrës,

Vitet kalojnë dhe bashkë me ne është rritur edhe institucioni për të cilin janë bërë 15 vjet jetë.

Besoj se mund të themi në mënyre krejt të përgjegjshme se kemi arritur të jemi një institucion funksional, i pavarur në vendimmarrje, laborator që performon dhe konkurren me kontributin e tij denjësisht në fushën e tij të veprimtarisë e ndoshta edhe më gjerë, përfshirë edhe procesin e integritetit evropian dhe veprimtarinë ndërkombëtare, në dy prej të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të drejtën për informim dhe të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, të hapur dhe komunikues me publikun dhe që meriton të vendoset në pozicionin e duhur kushtetues dhe institucional.

E drejta për informim, në të tre komponentet e saj, ku në qender është Qytetari, së bashku me Shoqërinë Civile, Median apo çdo aktor tjetër, me Autoritetet Publike, si dhe Zyra e Komisionerit, duhet të funksionojnë bazuar në një marrëdhënie luajaliteti institucional, sepse kjo garanton zbatimin e kësaj të drejte për të parët, ashtu si edhe reflekton transparencën dhe mirëqeverisjen për Autoritetet Publike.

Duke besuar te ky luajalitet, Zyra e Komisionerit e ka ndërtuar strategjinë e punës së saj te edukimi dhe ndërgjegjësimi.

Ne besojmë fort se, rregulli është transparenca, kufizimi i informacionit është përjashtim nga ky rregull.

Mbrojtja e të dhënave personale, e lidhur edhe me ngjarjet e fundit, kërkon seriozitetin dhe vendosjen e standardeve të larta nga kontrolluesit privat dhe publik.

Kërkohet ndërgjegjësim, nga vetë qytetarët në rradhë të parë, trajnim, investim në sisteme të mbrojtjes së sigurisë së informacionit, teknologji dhe burime njerëzore.

Këtë e kërkon fort Komisioneri, por e kërkon edhe më fort legjislacioni dhe Konventat, prandaj edhe miratimi i ligjit të ri që transponon GDPR nuk mund të vonojë më.

Të gjithë këto vite, në cilësinë e institucionit të specializuar, nëpërmjet vendimmarrjes jemi përpjekur të japim pjesën tonë të kontributit në krijimin e një vije sjellje dhe të jurisprudencës.

Këtu, një kontribut jo i vogël pritet edhe nga gjykata.

Kontributi i shoqërisë civile apo edhe medias investigative do të vijojë të mbetet një faktor i rëndësishëm në punën tonë, me rekomandimet apo edhe kritikën e tyre, ashtu si edhe vlerësimet, ndoshta pak të kursyera, por që ndihmojnë po njësoj kur janë të drejta.

Ju falemnderit të gjithë pjesëmarrësve në këtë aktivitet dhe veçanërisht për kontributin tuaj.